



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 185

Tiranë – E martë, 20 tetor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 6529/2, datë 6.10.2020	12649
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 279, datë 1.10.2020	12657
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 280, datë 1.10.2020	12664
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 281, datë 1.10.2020	12666
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 284, datë 7.10.2020	12670
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 577, datë 14.10.2020	12671



UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 6529/2, datë 6.10.2020

**PËR MBLEDHJEN, RUAJTJEN,
MARRJEN E MOSTRAVE DHE
RAPORTIMIN E TË DHËNAVE PËR
CILËSINË E BENZINËS, DIEZELIT,
GAZIT TË LËNGËT TË NAFTËS (GLN),
LËNDËVE DJEGËSE TË LËNGËTA TË
MESME-RËNDA, LËNDËVE DJEGËSE
TË LËNGËTA TË RËNDA, LËNDËVE
DJEGËSE TË LËNGËTA DETARE DHE
FURNIZUESIT E KËTYRE LËNDËVE
DJEGËSE TË LËNGËTA¹**

Në zbatim të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel”, si dhe të pikës 12, të kreut VIII të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 429, datë 26.6.2019 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Turizmit dhe Mjedisit,

UDHËZOJNË:

KREU I
MBLEDHJA DHE RUAJTJA E TË
DHËNAVE PËR CILËSINË E LËNDËVE
DJEGËSE TË LËNGËTA

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimtarinë nëpërmjet strukturave të specializuara të tyre për mbledhjen ruajtjen dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë, diezel, lëndë djegëse të lëngëta

të rënda (*heavy fuel oil*), lëngëta djegëse të mesme të rënda (*gas oil*) dhe lëndë djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*), sipas standardeve dhe afateve kohore të përcaktuara në vendimin nr. 147, datë 21.3.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel”, si dhe në vendimin nr. 429, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”.

2. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) mbledh dhe sistemon të dhënat nga prodhuesit vendas, nga tregtuesit me shumicë dhe pakicë dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) në lidhje me sasinë dhe cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë, diezel, lëndëve djegëse të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*), lëndëve djegëse të lëngëta të mesme të rënda (*gas oil*), dhe lëndëve djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*) dhe analizon shkallën e përputhshmërisë për secilin parametër fiziko-kimik të lëndëve djegëse me vlerat e standardeve në fuqi të përcaktuara në VKM-në nr. 147/2007 dhe VKM-në nr. 429/2019.

3. Rafineritë, impiantet e përpunimit dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë, pavarësisht detyrimeve të tjera për dërgim informacioni në institucionet shtetërore, detyrohen të dërgojnë pranë Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, çdo tre muaj, informacion në lidhje me llojin (sipas specifikimeve teknike), sasinë dhe cilësinë e lëndëve djegëse të hedhura në tregun e brendshëm.

4. Strukturat rajonale të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, në fillim të çdo viti, organizojnë në bashkëpunim me strukturat rajonale përgjegjëse për inspektimin mjedisor, programe pune të përbashkëta për marrjen e mostrave për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë, diezel, lëndëve djegëse të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*), lëngëta të mesme të rënda (*gas oil*), lëndëve djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*).

5. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial raporton çdo vit brenda datës 28 shkurt të dhënat e grumbulluara mbi sasinë dhe cilësinë e lëndëve djegëse për vitin paraardhës, në përputhje me formatet e raportimit të përcaktuara në kreun III, të këtij udhëzimi, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Të dhënat mbi

¹ Ky udhëzim i përbashkët transpozon pjesërisht vendimin zbatues të Komisionit (EU) 2015/253, të datës 16 shkurt 2015 mbi përcaktimin e rregullave për marrjen e mostrës dhe raportimit në kuadër të direktivës së Këshillit 1999/32/EC lidhur me përmbajtjen e squfurit në lëndët djegëse detare dhe vendimin e Komisionit 2002/159/KE, 18 shkurt 2002, për një format të përbashkët për dorëzimin e përmbledhjeve të të dhënave kombëtare mbi cilësinë e lëndëve djegëse.



sasitë do të jenë sipas informacioneve të dërguara nga shoqëritë tregtare dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ruan dhe administron informacionin e marrë nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe krijon bazën e të dhënave në lidhje me cilësinë e benzinës, diezelit, lëndë djegëse të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*), lëndë djegëse të lëngëta të mesme të rënda (*gas oil*), dhe lëndëve djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*). Një kopje e informacionit publikohet në faqen elektronike të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

KREU II FREKUENCA DHE METODAT E MARRJES SË MOSTRAVE

1. Për lëndët djegëse të lëngshme benzinë, diezel, lëndë djegëse të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*), lëngëta të mesme të rënda (*gas oil*) dhe lëndë djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*), frekuenca e marrjes së mostrave, kryerja e analizave, si dhe testimi i çdo treguesi fiziko-kimik, bëhet sipas metodave të analizave të referuara në VKM-në nr. 147/2007 dhe VKM-në nr. 429/2019 dhe të përcaktuara në standardet përkatëse në fuqi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve.

2. Përveç parashikimit në pikën 1, marrja e mostrave për lëndët djegëse të lëngëta detare kryhet si vijon:

a) frekuenca e marrjes së mostrave të lëndëve djegëse të lëngëta detare që përdoren në bordin e anijeve, për kontrollin e përmbajtjes së squfurit, kryhet për të paktën 30% të anijeve nga 10% e numrit mesatar të anijeve që lundruan në/nga portet shqiptare të hapura për trafikun ndërkombëtar në tri vitet e fundit;

b) marrja e mostrës dhe kontrolli i cilësisë së lëndëve djegëse të lëngëta detare kryhet edhe gjatë shpërndarjes së tyre në anije nga furnizuesit, nëse furnizuesi i karburantit ka furnizuar me lëndë djegëse të lëngëta detare së paku tri herë gjatë vitit kalendarik të kaluar, dhe cilësia e tyre nuk është në përputhje me notën e lëshuar;

c) për lëndët djegëse të lëngëta detare që përdoren (digjen) në bordin e anijeve, metodat e marrjes së mostrave për verifikimin e përmbajtjes së squfurit përfshijnë hapat e mëposhtme:

i. ISHTI-ja kontrollon regjistrat (*logbooks*) në anije dhe notën e lëshuar nga furnizuesi lidhur me përmbajtjen e squfurit në të;

ii. në rastin e lëndës djegëse, e cila është e vulosur në bordin e anijes, ISHTI-ja merr për analizë mostrat që shoqërojnë notën e lëshuar nga furnizuesi, në përputhje me rregulloren 18 (8.1) dhe (8.2) të shtojcës VI, të Konventës së MARPOL-it;

iii. në rastin kur lëndë djegëse, përdoret për t'u djegur në bordin e anijes, ISHTI-ja kryen marrjen e mostrës në përputhje me parashikimet e pikës 2(d), të këtij kreu;

iv. në fund të verifikimit dhe të analizës për përmbajtjen e squfurit, ISHTI-ja regjistron detajet e inspektimit të lëndës djegëse përkatëse dhe gjetjet/rezultatet në përputhje me llojin e informacionit të kërkuar, sipas pikës 8, të kreut III, të këtij udhëzimi;

d) ISHTI-ja kryen marrjen e mostrës së lëndës djegëse që përdoret (digjet) në bordin e anijes, përmes një mostre të vetme ose të shumëfishtë në vendin ku është vendosur një valvul, me qëllim marrjen e një kampioni në sistemin e shërbimit të lëndës djegëse, siç tregohet në sistemin e tubacionit të lëndës djegëse në anije ose në planin rregullues të tij;

e) kur vendndodhja e përmendur në pikën 2(d) të këtij kreu mungon, pika e marrjes së mostrës së lëndës djegëse do të jetë vendi ku ndodhet një valvul e përshtatshme për qëllime të marrjes së një kampioni, e cila duhet të plotësojë të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. të jetë lehtësisht e arritshme dhe e sigurt;

ii. të marrë parasysh nivele të ndryshme të lëndës djegëse që përdoren për makineritë e djegies së lëndës djegëse;

iii. të jetë në drejtim të rrjedhjes së karburantit në përdorim nga rezervuari i shërbimit;

iv. të jetë sa më afër pikës së hyrjes së lëndës djegëse në makinerinë që djeg lëndën djegëse, dhe sa më e sigurt të jetë e mundur duke marrë në konsideratë tipin e lëndës djegëse, shkallën e rrjedhjes, temperaturën dhe presionin prapa pikës së zgjedhur për marrjen e mostrës;

v. të propozohet nga përfaqësuesi i anijes dhe të pranohet nga inspektori i ISHTI-së;

f) kur sistemet e shërbimit për ndarjen e plotë të lëndës djegëse mungojnë, ose në rast të



rregullimeve të rezervave të shumta të shërbimit, një mostër mund të merret në më shumë se një vend në sistemin e shërbimit të lëndës djegëse për të përcaktuar nëse ekziston një kontaminim i mundshëm i lëndës djegëse;

g) inspektori i ISHTI-it siguron që mostra në vend mbledhet në një enë mbajtëse për mostra nga e cila mund të mbushen të paktën tri shishe kampionimi, përfaqësuese të lëndës djegëse detare që përdoret;

h) inspektorët e ISHTI-së marrin masat për të siguruar sa më poshtë:

i. shishet e mostrës vulosen nga inspektori i ISHTI - me një mjet unik identifikimi në prani të përfaqësuesit të anijes;

ii. dy nga shishet e mostrës çohen për analiza në laborator;

iii. një shishe mostre ruhet nga përfaqësuesi i anijes për një periudhë jo më pak se 12 muaj nga data e mbledhjes.

KREU III

FORMATET E RAPORTIMIT TË TË DHËNAVE TË LËNDËVE DJEGËSE TË LËNGËTA

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) harton raportin vjetor të cilësisë së lëndëve djegëse të lëngëta. Format i raportit përfshin:

1. Detaje mbi hartuesin e raportit të monitorimit të cilësisë së lëndëve djegëse të lëngëta, sipas formatit të tabelës 1, të shtojcës I, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

2. Përshkrim i sistemit të monitorimit të cilësisë së lëndëve djegëse të lëngëta;

3. Sasinë në total të benzinës dhe diezelit të shitur, sipas formatit të tabelës 2, të shtojcës I, bashkëngjitur këtij udhëzimi;

4. Të dhënat mbi cilësinë e benzinës dhe diezelit, në përputhje me specifikimet standarde të secilit produkt sipas formatit të tabelave 3,4,5,6, në shtojcën I, bashkëngjitur këtij udhëzimi;

5. Të dhënat mbi cilësinë e lëndëve djegëse të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*), lëndët djegëse të lëngëta të mesme të rënda (*gas oil*) dhe lëndët djegëse të lëngëta marine të rënda (*Marine Fuel*) në përputhje me specifikimet standarde të secilit produkt sipas shtojcave I, II, III dhe IV, të

vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 429, datë 26.6.2019 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”;

6. Të dhënat mbi sasinë e lëndëve djegëse të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*), lëndët djegëse të lëngëta të mesme të rënda (*gas oil*) dhe lëndët djegëse të lëngëta marine të rënda (*Marine Fuel*) në përputhje me formatin e tabelave të shtojcës II, të këtij udhëzimi;

7. Format i raportimit përmban gjithashtu informacion të detajuar mbi mostrat e marra për analize, si dhe përputhshmërinë e cilësisë së tyre me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

8. Përveç parashikimeve të pikave 1–6, të këtij kreu, për lëndët djegëse të lëngëta marine të rënda (*Marine Fuel*), raporti vjetor përfshin gjithashtu informacionin e mëposhtëm:

a) numrin e përgjithshëm vjetor dhe tipin e mospërputhshmërisë për përmbajtjen e squfurit të matur në lëndën djegëse, duke përfshirë edhe mospërputhjen e përmbajtjes individuale të squfurit dhe përmbajtjen mesatare të squfurit të përcaktuar sipas mostrave të marra dhe analizuar;

b) numri i përgjithshëm vjetor i verifikimeve të dokumenteve, duke përfshirë notën e lëshuar

nga depoja e karburantit vendndodhjen e depos së karburantit (furnizuesi), regjistrat e të dhënave të lëndës djegëse *log books* (regjistrat), procedurat e ndërrimit të lëndës djegëse dhe të dhënat e ruajtura;

c) pohimet mbi mosdisponueshmërinë e lëndëve djegëse të lëngëta detare, përfshirë të dhënat mbi anijet, depon e karburantit të portit dhe vendin ku ka ndodhur mos disponueshmëria, numri i kërkesave të bëra nga e njëjta anije, dhe lloji i depos së karburantit të padisponueshëm;

d) njoftime dhe letra proteste lidhur me përmbajtjen e squfurit në lëndët djegëse kundër furnizuesve me lëndë djegëse detare në territorin e tyre;

e) një listë që përmban emrin dhe adresën e të gjithë furnizuesve me lëndë djegëse detare;

f) përshkrimin e përdorimit të metodave alternative për reduktimin e emetimeve nga anijet, përfshirë provat dhe monitorimin e vazhdueshëm të emetimeve, ose lëndë djegëse



alternative dhe kontrollet e përputhshmërisë për të arritur vazhdimisht reduktimin e SO_x në përputhje me shtojcat V dhe VI të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 429, datë 26.6.2019 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor);

g) numrin e përgjithshëm dhe tipin e procedurave të iniciuara në rast shkelje ose dënimit ose të dyja, shumën e gjobave të vendosura nga autoriteti kompetent si për operatorët e anijes, ashtu edhe për furnizuesit e lëndëve djegëse të lëngëta detare;

h) për çdo anije individuale, në vijim të inspektimit të *log books* (regjistrave), të notës së lëshuar nga depoja e karburantit (furnizuesi) ose, marrjes së mostrave ose, për të dyja rastet;

i. veçoritë e anijes, duke përfshirë numrin IMO, tipin, moshën e anijes dhe tonazhin;

ii. raportet mbi mostrat e marra dhe analizat, duke përfshirë numrin dhe llojin e mostrave, metodat e përdorura për marrjen e mostrave dhe vendet e marrjes së tyre, për verifikimin e përputhshmërisë së tipit të anijes;

iii. informacione përkatëse për notën e lëshuar nga depoja e karburantit (furnizuesi), vendndodhjen e depos së karburantit (furnizuesi), librat e regjistrave të lëndëve djegëse, procedurat e ndryshimit të karburantit dhe të dhënat e ruajtura;

iv. masat zbatuese dhe procedurat ligjore të iniciuara në nivel kombëtar ose, gjobat ose të dyja kundër asaj anije individuale.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi i përbashkët nr. 6, datë 9.10.2007, i ish-Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe ish-Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, “Për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë e benzinës dhe të dieselit”, shfuqizohet.

2. Udhëzimi i përbashkët nr. 3946, datë 10.6.2016 “Për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse të lëngëta të mesme të rënda (*Gas Oil*), lëndëve djegëse të lëngëta të rënda (*Heavy Fuel Oil*) dhe lëndëve djegëse të lëngëta marine të rënda (*Marine Fuel*)”, shfuqizohet.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, struktura përgjegjëse për inspektimin mjedisor, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi



SHTOJCË I

Tabela 1. Të dhëna mbi autoritetin që harton raportin monitorimin e lëndëve djegëse

Viti i raportimi	
Data e raportimit	
Institucioni përgjegjës për raportimin	
Adresa e institucionit	
Personi përgjegjës për hartimin e raportit	
Numri i telefonit	
Adresa e e-mail-it	

Tabela 2. Të dhëna mbi sasinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diezel

Kategoria e lëndës djegëse	Prodhimi Litra/tonnes	Importi Litra/tonnes	Eksporti Litra/tonnes	Konsumi/shitje ** Litra/tonnes
1	2	3	4	5
Benzinë pa plumb (minimumi RON=91)				
Benzinë pa plumb (minimumi RON=95)				
Benzinë pa plumb (minimumi RON=95) dhe përmbajtje squfuri më të ulët se 50 ppm				
Benzinë pa plumb me përmbajtje squfuri më të ulët se 10 ppm				
Benzinë pa plumb (95≤RON<98)				
Benzinë pa plumb RON: ≥ 98				
Diezel total				
Diezel me dhe përmbajtje squfuri më të ulët se 50 ppm				
Diezel dhe përmbajtje squfuri më të ulët se 10 ppm				
LPG Totali				



TË DHËNA PËR CILËSINË E BENZINËS

Tabela 3. Lëndë djegëse në treg të përdorura në automjete me motorë me ndezje shkëndije (benzinë)*

Parametra	Njësia	Rezultatet analitike dhe statistikore						Vlera kufi (limit)			
								Specifikimet kombëtare		Sipas 98/70/KE	
		Numri i mostrave	Marrë Ku	Min	Max	Mënyra/mjeti	Devijimi standard	Minimum	Maksimum	Min	Max
Numri i kërkuar i oktanit										95	-
Numri i oktanit për motorin										85	
Presioni avullit, DVPE	kPa									-	60.0
Distilimi:										46.0	-
- Përqindje e avulluar në 100°C	%(v/v)									75.0	-
- Përqindje e avulluar në 150°C	%(v/v)										
Analiza e hidrokarbureve:											18.0
- Olefinat	%(v/v)										42.0
- Aromatikët	%(v/v)										1.0
- Benzene	%(v/v)										
Përmbajtja e oksigjenit										-	2.7
Oksigjenate:											
- Metanol	%(v/v)									-	3
- Etanol	%(v/v)									-	5
- Alko-ol iso-propil	%(v/v)									-	10
- Alko-ol tert-butyl	%(v/v)									-	7
- Alko-ol iso-butyl	%(v/v)									-	10
- Etere me përmbajtje me 5 ose më shumë atome karboni për molekulë	%(v/v)									-	15
- Oksigjenate të tjera	%(v/v)									-	10
Përmbajtja e squfurit	mg/kg									-	150
Përmbajtja e plumbit	g/l									-	0.005

* Sipas formatit të përbashkët për dorëzimin e përmbledhjes të të dhënave kombëtare për cilësinë e lëndëve djegëse (direktiva 98/70/KE)



Tabela 4. Numri i mostrave benzinë në muaj

Numri i mostrave benzinë në muaj						Totali	
Janar		Prill		Korrik		Tetor	
Shkurt		Maj		Gusht		Nëntor	
Mars		Qershor		Shtator		Dhjetor	

Tabela 5. Lëndë djegëse në treg të përdorura në automjete me motorë me ndezje me ngjeshje (dizel)*

Parametra	Njësia	Rezultatet analitike dhe statistikore					Vlera kufi (limit)			
							Specifikimi kombëtar		Sipas 98/70/KE	
		Numri i mostrave	Min	Max	Mënyra	Devijim standard	Minimum	Maksimum	Minimum	Maksimum
Numri i Cetanit									51,0	-
Densiteti në 15°C	kg/m ³								-	845
Pika e distilimit 95%	15°C								-	360
Hidrokarbure policiklike aromatike	% (m/m)								-	11
Përmbajtja e squfurit	mg/kg								-	350 nga 01.01.2009 - 31.12.2010; 10 nga 01.01.2011
	% (m/m)									0.30
	% (m/m)									0.01
	mg/kg									24

*Sipas formatit të përbashkët për dorëzimin e përmbledhjes të të dhënave kombëtare për cilësinë e lëndëve djegëse (direktiva 98/70/KE)

Tabela 6: Numri i mostrave në muaj (dizel)

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Mars	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali



SHTOJCË II

I. **Formati i tabelave me të dhënat cilësore të lëndëve djegëse të lëngëta** të rënda (*Heavy Fuel Oil*), lëndët djegëse të lëngëta të mesme të rënda (*Gas Oil*) dhe lëndët djegëse të lëngëta marine të rënda (*Marine Fuel*), janë përcaktuar në shtojcat I, II, III dhe IV të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 429, datë 26.6.2019 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor).

II. **Formati i tabelave me të dhënat sasiore të lëndëve djegëse të lëngëta** të rënda (*Heavy Fuel Oil*), lëndët djegëse të lëngëta të mesme të rënda (*Gas Oil*) dhe lëndët djegëse të lëngëta marine të rënda (*Marine Fuel*), paraqitet në tabelat më poshtë:

Tabela 1. Numri i mostrave në vit (*Heavy Fuel Oil*)

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Mars	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali

Tabela 2. Numri i mostrave në vit (*Gas Oil*)

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Mars	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali

Tabela 3. Numri i mostrave në vit (*Marine Fuel*)

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Mars	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali

**URDHËR****Nr. 279, datë 1.10.2020****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR USHTRIMIN E FUNKSIONIT
MBIKËQYRËS TË MINISTRISË NË
AKTIVITETIN E OPERATORËVE TË
GAZIT NATYROR PËR KOORDINIMIN
E OPERACIONEVE NË TERREN**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të germës “ç”, të pikës 2, të kreut III, të vendimit nr. 573, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave dhe të procedurave në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse në sektorin e gazit natyror të ministrisë përgjegjëse për energjinë”, si dhe të germës “ç”, të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 410, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”,

URDHËROJ:**KREU I****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Mbikëqyrja dhe inspektimi i aktivitetit në
sektorin e gazit natyror****1. Kërkesa të përgjithshme**

a) Ministria përgjegjëse për sektorin e gazit natyror ushtron funksionin mbikëqyrës në operatorin e transmetimit të gazit natyror, në operatorin e shpërndarjes së gazit natyror, në operatorin e magazinimit nëntokësor të gazit natyror, si dhe në operatorin e terminalit të gazit natyror të lëngëzuar (GNL), nëpërmjet realizimit dhe koordinimit në terren të inspektimeve të natyrës teknike, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe të rregullave teknike të miratuara në bazë dhe për zbatim të këtij ligji. Inspektimet e natyrës teknike kryhen nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet përmes përfshirjes së Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve (DPZHFH), si struktura e saj përgjegjëse për sektorin e gazit natyror, si dhe përfshirjes së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe

Industrial (ISHTI), si institucioni inspektues shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror, brenda objektit të tyre të punës të përcaktuar me ligj.

b) Rrjetet e transmetimit, të shpërndarjes, të magazinimit nëntokësor të gazit natyror, si dhe terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL), të garantojnë sigurinë dhe efikasitetin teknik e teknologjik të transportit të gazit natyror si burim energjie me parametrat e presionit dhe të rrjedhjes të përcaktuar nga dokumentacioni i projektit dhe kushtet e operimit.

c) Me qëllim të zbulimit të rrugëve të tubacioneve të transmetimit dhe të shpërndarjes, si dhe të tubacioneve të impianteve/instalimeve të tjera të gazit natyror, të vendosen shënimet përkatëse për tubacionet nëntokësore të gazit, duke përdorur shenjat e identifikimit që përmbajnë informacion mbi diametrin e tubacionit, presionin e gazit në të, thellësinë e tubacionit, materialin e tubave, distancën në tubacion, numrat e telefonit të shërbimeve emergjente të operatorëve që veprojnë në këtë pjesë të tubacionit dhe informacione të tjera.

2. Fusha e veprimit

a) Mbikëqyrja inspektuese teknike mbulon mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, rregulloreve dhe akteve, standardet, normat e përgjithshme teknike dhe standardet e cilësisë, të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e aktiviteteve të gazit natyror, projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e objekteve të gazit, si dhe mbikëqyrjen e cilësisë së gazit natyror që shpërndahet për konsumatorët.

b) Projektimi, ndërtimi, rindërtimi/riparimi, instalimi dhe operimi i tubacioneve dhe impianteve/instalimeve të gazit natyror kryhen duke marrë parasysh karakteristikat që lidhen me terrenin, strukturën gjeologjike të tokës, regjimin hidrogeologjik, kushtet sizmike dhe praninë e minierave/vendburimeve nëntokësore.

c) Ministria krijon një bazë të dhënash për realizimin e inspektimeve teknike në terren në operatorët e gazit natyror, që ushtrojnë funksionin e transmetimit, të shpërndarjes dhe të magazinimit nëntokësor të gazit natyror, si dhe të terminalit të gazit natyror të lëngëzuar (GNL).



Neni 2

Menaxhimi i rrjetit të gazit natyror

1. Aktivitetet e transmetimit, të shpërndarjes dhe të magazinimit nëntokësor të gazit natyror, si dhe të operimit të terminalit të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) bazohen në programet e kërkuara nga përdoruesit e rrjetit/instalimit, në kushte efikase, në besueshmërinë dhe sigurinë teknike, të garantuar nga këto subjekte nëpërmjet operimit të rrjetit të tubacionit apo instalimit përkatës. Operatorët e transmetimit, të shpërndarjes dhe të magazinimit nëntokësor të gazit natyror, si dhe të operimit të terminalit të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) duhet të kenë një strukturë dispeçerimi të aftë për të siguruar aktivitetet e mësipërme në kompleksitetin e rrjetit të vet.

2. Operatorët e transmetimit, të shpërndarjes dhe të magazinimit nëntokësor të gazit natyror, si dhe të operimit të terminalit të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) të kenë një sistem të telekomunikacionit/internetit, i cili përveç mbështetjes së aktivitetit të sigurimit të lidhjes dhe të transmetimit të të dhënave me të gjithë operatorët e sistemit, të sigurojë lidhjen telefonike dhe lidhjen *online* me internet me stafin për ndërhyrjet në rastet për mirëmbajtjen e zakonshme, të jashtëzakonshme dhe emergjente.

Neni 3

Inspektimi teknik dhe mirëmbajtja/riparimi i sistemit të gazit**1. Kritere të përgjithshme**

a) Për të garantuar përmbushjen e kushteve të nevojshme të besueshmërisë dhe sigurisë teknike, tubacionet e transportit të gazit, stacionet e kompresimit dhe instalimet e tjera të gazit natyror të jenë subjekt i aktiviteteve të nevojshme të inspektimit dhe të mirëmbajtjes së zakonshme dhe të jashtëzakonshme.

b) Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve, si struktura përgjegjëse për sektorin e gazit natyror e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), si dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), si institucioni inspektues shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror, në koordinim me operatorët e transmetimit, të shpërndarjes dhe të magazinimit nëntokësor të

gazit natyror, si dhe të operimit të terminalit të gazit natyror të lëngëzuar (GNL), të përgatisin për secilin operator plane inspektimi lidhur me gjendjen teknike dhe mirëmbajtjen e instalimeve/pajisjeve përkatëse. Këto struktura duhet t'i dokumentojnë planet e inspektimit në një regjistër të veçantë, i cili mundet, gjithashtu, të jetë i tipit elektronik, përfshirë ekzekutimin e ndërhyrjeve të mirëmbajtjes/riparimit, rezultatet e vetë ndërhyrjeve dhe ato eventuale për gjetjen e anomalive. Mirëmbajtja duhet të synojë ruajtjen ose raportimin për pajisjet, nëse ato kryejnë funksionin e kërkuar, si një garanci e besueshmërisë për sigurinë e shërbimit.

c) Operacionet e inspektimit teknik kryhen në vend dhe konsistojnë në verifikimin e procedurave dhe të kërkesave të sigurisë teknike, me qëllim garantimin e mbrojtjes së personelit operativ, të pronës dhe të jetës së njerëzve, si dhe përdorimin saktë të pajisjeve për funksionimin e tyre.

ç) Gjatë inspektimit teknik në terren duhet pasur në konsideratë që operacionet e mirëmbajtjes/riparimit, pavarësisht nga natyra e ndërhyrjes dhe operacionit që duhet kryer, të realizohen nga një personel i kualifikuar. Integriteti dhe funksionaliteti i komponentëve të instaluar, për reduktimin e presionit dhe tubacionet, në veçanti, duhet të verifikohen në mënyrë periodike.

2. Testimi i sigurisë së tubacionit

a) Operatori ekonomik i sektorit të gazit natyror të ketë një program gjithëpërfshirës për të verifikuar statusin, fortësinë dhe sigurinë teknike të sistemit të gazsjellësit të gazit natyror.

b) Operatori ekonomik i sistemit të gazit natyror të zotërojë pajisje moderne për kontrollin e brendshëm të linjave të punës nëpërmjet internetit. Këto pajisje mund të pajisen me kamera dhe sensor robotik për të kontrolluar spesoret e tubacioneve dhe të zbulojnë defektet nga korrozioni.

i. Inspektimet në linjë

Kontrolli i tubacionit të zbatohet me qëllim që:

i.1 të kontrollojë funksionalitetin dhe gjendjen e ruajtjes së seksioneve nëntokësore të tubacionit;

i.2. të kontrollojë ruajtjen e mirë të shenjave të tubacioneve, duke siguruar inspektimet e duhura që zbulojnë praninë e gazit në kalimet dhe në tubat mbrojtës dhe të tubacioneve vetë;

i.3. të konstatojë ndonjë veprim të palës së tretë që mund të jetë me interes në zonat e inspektimit të tubacioneve dhe të distancave relative të sigurisë.



Frekuenca e kryerjes së kontrollit të një tubacioni do të jetë e përcaktuar në bazë të kushteve të projektimit dhe të operimit dhe karakteristikat e territoreve mbi të cilat është vendosur tubacioni (niveli i urbanizimit të territorit, shkalla e qëndrueshmërisë së tokës).

ii. Testimi hidrostatik

Testimi hidrostatik përfshin presimin e një tubi me ujë për të zbuluar pikat me të dobëta të mundshme të tubacionit. Kjo është një metodë e provuar për verifikimin e aftësisë së një tubacioni të gazit natyror për të operuar në një nivel të sigurt presioni.

Për kryerjen e një prove hidraulike operatori ekonomik të kryejë hapat e mëposhtëm:

ii.1. Seksioni i tubacionit që do të testohet nxirret nga puna dhe pastrohet nga gazit natyror dhe mbeturinat mekanike nga brenda.

ii.2. Seksioni i tubacionit bllokohet nga të dyja anët dhe mbushet me ujë.

ii.3. Testimi i tubacioneve konsiderohet i favorshëm nëse pas të paktën 48 orë, presioni mbetet konstant dhe se, për shkak të ndikimit të temperaturës, vëllimi i lëngu mbetet konstant brenda kufijve të saktësisë së instrumenteve matëse të përdorura.

ii.4. Në rastin e tubacioneve të shkurtër mbi tokë, testimi konsiderohet i favorshëm nëse, pas së paku 4 orëve.

Për tubacionet e stacionit të kompresorëve kohëzgjatja minimale e testit hidraulik është 24 orë.

Nëse nuk ka humbje të ndjeshme të presionit, atëherë pjesa e gazsjellësit, zbrazet nga uji, hahet tërësisht dhe vendoset përsëri në punë.

Nëse një seksion nuk mban presionin do të thotë që testimi hidrostatik ka zbuluar rrjedhje dhe dëmtime të tubacionit, defekti riparohet dhe seksioni i tubacionit testohet përsëri. Seksionet që nuk kalojnë testin hidraulik duhet të zëvendësohen.

iii. Inspektimi me kamera

iii.1. Për kryerjen e këtij inspektimi operatori ekonomik i sektorit të gazit natyror të hapë disa dritare në të gjithë gjatësinë e tubacionit. Për sigurinë e publikut këto nyja kontrolli do të mbyllen duke u flanaxhuar pas vënies në punë të gazsjellësit.

iii.2. Kamera e lidhur që do të futet në dritaret e hapura në të gjithë gjatësinë e linjës së transmetimit do të regjistrojë kushtet e brendshme të tubacionit. Videoja do të përcillet në një pajisje monitorimi

dhe regjistrimi aty pranë. Profesionistët e trajnuar do të analizojnë atë dhe do të përcaktojnë nëse janë të nevojshme masat shtesë.

iv. Monitorimi i tubacioneve në det

iv.1. Duhet të kryhet kontrolli i tubacioneve nënujore përmes inspektimeve periodike në det dhe në pjesën me thellësi të ulët, ashtu edhe në ujërat e thella.

iv.2. Duhet të përdoren mjetet e duhura të pajisura me video dhe sisteme instrumentale që lejojnë një pasqyrë të gjendjes së jashtme të tubacionit të shtirë në shtratin e detit dhe të ndërveprimit të saj me vetë shtratin e detit, për të verifikuar gjendjen e tyre, kushtet e mbrojtjes mekanike dhe elektrike të pranishme.

iv.3. Të gjitha kryqëzimet me tubacionet e tjera, kabllot elektrike dhe të telekomunikacionit duhet të monitorohen.

iv.4. Operacionet e mirëmbajtjes duhet të synojnë kryesisht stabilizimin e tubit në fund dhe mbrojtjen e tij kundër çdo ndërhyrjeje të veprimtarive njerëzore (lundrimit, trafikut detar komercial dhe rekreativ).

v. Masat dhe kontrollet për mbrojtje nga korrozioni

Përgjatë trasesë së tubacioni duhet të vendosen dhe të përcaktohen masa për të konstatuar efektivitetin e sistemeve të mbrojtjes katodike, në lidhje me programet e përcaktuara në planet e mirëmbajtjes. Mbrojtja katodike duhet të jetë subjekt i inspektimeve për të konstatuar gjendjen e tubacioneve të gazit, në përputhje me kërkesat teknike në fuqi.

vi. Anijet e Gazit Natyror të Lëngëzuar (GNL)

vi.1. Enët dhe pajisjet nën presion që shërbejnë për transportimin ujor/detar të gazit natyror të lëngëzuar duhet të jenë objekt i operacioneve të inspektimit për të verifikuar integritetin e tyre. Nëse operacionet e inspektimit gjejnë defekte që mund të ndikojnë në funksionalitetin e tyre, veprimi më i përshtatshëm është rivendosja e integritetit strukturor të komponentit, duke kryer riparimet e nevojshme për vendosjen e qëndrueshmërisë.

vi.2. Këto operacione inspektimi të kenë një frekuencë dhjetëvjeçare; frekuenca e këtyre kontrolleve duhet të ndryshohet nëse prodhuesit e këtyre pajisjeve në manualin e përdorimit dhe të mirëmbajtjes ndryshojnë periodicitetin e kontrollit.



vi.3. Operacionet e inspektimit për kontrollet e integritetit konsistojnë në një ekzaminim vizual të kryer nga jashtë dhe, kur është e mundur në brendësi, për kontrollet e trashësisë së enëve dhe çdo ekzaminim tjetër që është i nevojshëm për vlerësimin e dukshëm të dëmtimit.

vii. Pajisjet e sigurisë

vii.1. Pajisjet e sigurisë të jenë objekt i operacioneve për verifikimin e funksionalitetit të tyre.

vii.2. Verifikimi i funksionalitetit të aksesorëve të sigurisë do të kryhet me teste në bango-provë me simulime ose aty ku është e mundshme dhe jo e dëmshme për kushtet e operimit.

vii.3. Verifikimi i funksionalitetit të aksesorëve të sigurisë duhet kryhet normalisht çdo dy vjet.

vii.4. Frekuenca e ekzekutimit të këtij verifikimi është specifike për secilën prej tyre, sipas llojit të pajisjeve dhe përcaktohet duke mbajtur parasysh kushtet e punës.

vii.5. Analiza e kushteve të operimit dhe modalitetet e menaxhimit të aksesit të sigurisë mund të përcaktojë ekzekutimin e verifikimit të funksionalitetit me frekuencë të ndryshme (më të ulët ose më të lartë).

Neni 4

Kushtet për kryerjen e mbikëqyrjeve inspektuese nga ana e inspektorëve

Operatorët ekonomikë të gazit natyror janë të detyruar t'u krijojnë kushte inspektorëve dhe të mos pengojnë mbikëqyrjen inspektuese, për të lejuar hyrjen e tij dhe për të verifikuar të gjitha çështjet e parashikuara në program në objektet e operatorëve ekonomikë të sektorit të gazit natyror, duke vënë në dispozicion të tyre të gjitha të dhënat e kërkuara, dokumentet dhe raportet e kërkuara për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese.

KREU II

MËNYRA DHE PROCEDURA E INSPEKTIMIT

Neni 5

Inspektimi i programuar

1. Një inspektim konkret në operatorët ekonomikë të sektorit të gazit natyror autorizohet, si rregull, në bazë të programit të inspektimit.

2. Programi i inspektimi hartohet nga vetë inspektorati, bazuar në metodologjitë e vlerësimit të rrezikut dhe në detyrimin për inspektimin periodik.

3. Programi i inspektimit të inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror (ISHTI), miratohet nga ministri përgjegjës pas marrjes së mendimit këshillimor nga Inspektorati Qendror.

Neni 6

Inspektimi jashtë programit (rastësor, rast aksidenti, i kombinuar)

1. Përjashtimisht, një inspektim konkret mund të autorizohet jashtë programit të inspektimit në rastet, kur:

a) operatori ekonomik i sektorit të gazit natyror, që detyrohet të paraqesë një informacion periodik, sipas ligjit të posaçëm, nuk e ka përmbushur këtë detyrim brenda afatit të caktuar, nuk e ka përmbushur në mënyrë të plotë apo ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e informacionit të paraqitur;

b) ndodhja e ngjarjeve, avarive apo aksidenteve kanë cenuar apo mund të cenojnë jetën a shëndetin e njerëzve, kafshëve apo mjedisin;

c) nga monitorimi dhe mbikëqyrja e kryer nga inspektoratet, nëpërmjet analizës periodike dhe të vazhduar të të dhënave dhe informacioneve, lind dyshimi i arsyeshëm për shkeljen e kërkesave ligjore dhe arrihet në përfundimin se është i nevojshëm fillimi i një inspektimi;

ç) si pasojë e informacionit të marrë nga një institucion publik shqiptar apo një shtet tjetër a një organizatë ndërkombëtare, konsiderohet i nevojshëm fillimi i një inspektimi;

d) ministri mund të urdhërojë me shkrim dhe në mënyrë të motivuar, fillimi e një inspektimi për një subjekt të caktuar apo për një çështje konkrete që përfshin më shumë se një subjekt;

dh) organi ekzekutiv i njësisë së qeverisjes vendore mund të urdhërojë, me shkrim dhe në mënyrë të motivuar, fillimin e një inspektimi për një subjekt të caktuar apo për një çështje konkrete që përfshin më shumë se një subjekt.

2. Një inspektim, jashtë programit, mund të autorizohet edhe në bazë të një denoncimi apo informacioni të marrë nga të tretët, nëse krijohet dyshimi i arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore nga një subjekt.



3. Personi, që ka paraqitur denoncimin, informohet në përfundim të procedimit të inspektimit për rezultatet e tij.

Neni 7 Njoftimi i inspektimit

1. Njoftimi i inspektimit kryhet nëpërmjet njoftimit paraprak të subjektit të inspektimit jo më vonë se 3 ditë përpara fillimit të veprimeve të inspektimit.

2. Njoftimi paraprak nuk kryhet në këto raste:

- a) kur ekziston rreziku që njoftimi mund të pengojë kryerjen me efektivitet të inspektimit;
- b) për inspektimin për verifikimin e korigjimit të shkeljeve në përfundim të afatit të përcaktuar;
- c) për inspektimet e parashikuara për kontrollin e cilësisë;
- d) për inspektimin rastësor.

3. Pavarësisht nga njoftimi paraprak, në çdo rast, inspektori, përpara fillimit të veprimeve të inspektimit, informon, verbalisht, përfaqësuesin e subjektit të inspektimit për objektin e inspektimit dhe për të drejtat dhe detyrimet e subjektit të inspektimit, sipas ligjit, si dhe për pasojat ligjore nga mosrespektimi i këtyre detyrimeve

Neni 8 Marrja e kopjeve dhe sekuestrimi i dokumenteve

1. Gjatë inspektimit, inspektori ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë kopje të dokumenteve të veprimtarisë, në përputhje me objektin e inspektimit. Kërkesa bëhet me gojë dhe pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit. Çdo kopje dokumenti e marrë nënshkruhet nga përfaqësuesi i subjektit të inspektuar.

2. Inspektori ka, gjithashtu, të drejtë të sekuestrojë dokumente që lidhen me objektin e inspektimit, me qëllim verifikimin e autenticitetit apo korrektesisë së informacionit. Vendimi i sekuestrimit të dokumenteve pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit dhe përmban përshkrimin e plotë të dokumenteve të sekuestruara.

Neni 9

Të drejta të tjera të inspektorëve gjatë kryerjes së inspektimeve teknike

1. Përveç sa parashikohet më sipër në këtë rregullore, inspektori, brenda objektit dhe qëllimit të inspektimit, ka edhe këto të drejta:

a) të kryejë fotografime, filmime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike të mjediseve, instalimeve, proceseve të punës dhe godinave, mjediseve, objekteve, mjeteve të transportit, instalimeve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendeve, substancave, përbërësve dhe çdo sendi tjetër, që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektimit të gazit natyror;

b) të inspektojë çdo dokument apo regjistrim të nevojshëm për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, përfshirë edhe ato të ruajtura, të krijuara apo të mbajtura në format elektronik apo çdo teknikë tjetër;

c) të bëjë matjet e nevojshme për të verifikuar respektimin e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit;

ç) të kryejë verifikime të dokumenteve për identitetin e personave, kur kjo është e nevojshme, sipas objektit të inspektimit;

d) t'i kërkojë subjektit të inspektimit apo punëmarrësve të tij të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar inspektimin;

dh) të marrë pa pagesë dhe të përdorë për qëllimet e inspektimit çdo të dhënë për subjektin e inspektimit dhe veprimtarinë e tij, nga çdo institucion shtetëror që i disponon ato.

Neni 10

Menaxhimi i emergjencave

1. Përcaktohen si emergjenca çdo ngjarje që ndodh gjatë vitit në sistemin e transportit, depozitimit apo konsumit të gazit natyror që mund të jetë i dëmshëm ndaj sigurisë së personave dhe pronës, për pronën e palëve të treta, për mjedisin në përgjithësi ose për sigurinë e instalimit dhe vazhdimësinë e transportit.

Për t'u marrë me këto lloje të emergjencave kompanitë e transportit dhe të depozitimit të gazit të kenë një strukturë organizative në territorin që përdoret nga rrjeti i tyre, e aftë për të siguruar disponueshmërinë për ndërhyrje brenda njëzet e



katër orëve në mënyrë të shpejtë në sistemet e gazit.

Operatori i transportit dhe i depozitimit të ketë një procedurë për menaxhimin emergjent, në të cilën duhet të përcaktohen masat organizative dhe kriteret për përgatitjen dhe përdorimin e personelit, mjeteve, pajisjeve dhe materialeve.

Kjo procedurë të mbahet vazhdimisht e azhurnuar për personelin operacional të kompanisë të përfshirë në menaxhimin e emergjencave, i cili është trajnuar për të kryer veprime të sakta.

2. Kompania e transportit dhe të depozitimit kërkohej të ketë një sistem automatik të klasifikimit të informacionit aktiv, e cila funksionon vazhdimisht për marrjen e njoftimeve telefonike nga palët e treta, në lidhje me problemet që lidhen me aktivitetin e transportit dhe depozitimin.

Neni 11

Masat urgjente

1. Inspektori i sektorit të gazit natyror, gjatë inspektimit, ka të drejtë që, me vendim të ndërmjetëm, të marrë masa urgjente, kur:

a) për shkak të shkeljes së konstatuar të kërkesave ligjore mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i pariparueshëm i interesit publik apo i palëve të treta, veçanërisht kur është e nevojshme për të shmangur një rrezik të menjëhershëm për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve a për mjedisin;

b) ka një dyshim të arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore, nga i cili mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i pariparueshëm i interesit publik apo i palëve të treta dhe është e nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtejshme dokumentare ose kryerja e ekzaminimeve apo analizave;

c) gjatë inspektimit konstatohet se pajisjet e operatorëve ekonomikë nuk përmbushin kërkesat teknike, pavarësisht se për shfrytëzimin e tyre është marrë autorizimi përkatës, mund të bëjnë ndalimin e funksionimit të mëtejshëm të tyre deri në një afat të caktuar i cili përcaktohet në procesverbalin e inspektimit, sipas ligjit 102/2015, datë 23.9.2015, të ndryshuar.

2. Ndalimi i funksionimit të përkohshëm të pajisjeve kryhet duke i bllokuar dhe i vulosur pajisjet me vulë të veçantë të institucionit.

Neni 12

Raportimi dhe hetimi i aksidenteve

1. Kur ndodh një aksident që përfshin një instalim të sektorit të gazit natyror i cili rezulton me plagosjen apo humbjen e jetës së një personi, nga një zjarr apo shpërthim, operatori ekonomik ose agjenti i tij të njoftojë menjëherë kryeinspektorin dhe inspektorin e gazit natyror që mbulon zonën përkatëse, duke deklaruar vendndodhjen e saktë të aksidentit, natyrën e tij dhe rezultatet.

2. Inspektori i sektorit të gazit natyror paraqitet menjëherë në vendin e ndodhjes së aksidentit, pezullon çdo veprim që mund të çojë në ndryshimin e rrethanave të ngjarjes, me përjashtim të veprimeve për shpëtimin e personave të plagosur dhe largimin e personave të vrarë. Menjëherë përgatit informacionin për kryeinspektorin, i cili njofton menjëherë organet eprore për rrethanat, shkaqet dhe pasojat e ngjarjes.

3. Inspektori mund të marrë pjesë në grupet e hetimit për hetimin e një plagosjeje apo vdekjeje, një zjarri ose shpërthimi, kur ka arsye të besueshme se ai ka ndodhur nga instalimet e gazit natyror.

4. Asnjë ligj ose rregullore nuk pakëson përgjegjësinë e ndonjë personi për dëmet në lidhje me plagosjen ose aksidentimin me vdekje të një personi tjetër ose dëmtimin e shkatërrimin e pronës.

Neni 13

Mbajtja dhe njoftimi i procesverbalit të inspektimit

1. Inspektori që kryen inspektimin mban procesverbalin e inspektimit. Nëse veprimet e inspektimit i kanë kryer më shumë se një inspektor, në bazë të një autorizimi të vetëm, ata e mbajnë procesverbalin së bashku. Procesverbali i inspektimit mbahet në tri kopje, të cilat nënshkruhen nga inspektori apo inspektorët që e kanë mbajtur dhe përfaqësuesi i subjektit.

2. Procesverbali, si rregull, mbahet në vendin e inspektimit dhe i njoftohet pa vonesë subjektit të inspektimit nëpërmjet dorëzimit personal. Nëse përfundimi i procesverbalit në vendin e inspektimit nuk është i mundur, ai përfundohet në zyrat e inspektoratit dhe njoftohet brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të inspektimit.



3. Procesverbali përmban informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe shoqërohet me listëverifikimin e plotësuar gjatë inspektimit.

4. Procesverbali i inspektimit përmban, gjithashtu, informacion për të drejtën e subjektit të inspektimit që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal, brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, si dhe në procesverbal përcaktohet edhe organi ku paraqiten këto komente. Pas kalimit të këtij afati, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtijshëm i subjektit të inspektimit. Shpjegimet apo kontestimet e subjektit të inspektimit janë pjesë e dosjes.

Neni 14

Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, vendimi përfundimtar i inspektimit merret nga inspektori apo inspektorët që kanë kryer inspektimin, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit subjektit të inspektimit.

2. Nëse ligji i posaçëm parashikon që vendimi përfundimtar i inspektimit merret nga një njësi apo organ tjetër, atëherë procesverbali i hartuar, sipas nenit 45, të ligjit 10433, datë 16.3.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i përcillet, pa vonesë, kësaj njësie a organi, së bashku me propozimin e inspektorit. Organi tjetër vendos brenda afatit të parashikuar sipas këtij ligji.

3. Nëse ligji i posaçëm parashikon që inspektori duhet të shqyrtojë dhe të marrë një vendim përfundimtar, aty për aty, në përfundim të inspektimit, inspektori i sektorit të gazit natyror përpara marrjes së vendimit i shpjegon subjektit të inspektimit shkeljet e konstatuara, nëse ka të tilla, dhe vendimin që synon të marrë, duke dëgjuar shpjegimet apo kontestimet e tij, të cilat pasqyrohen në procesverbal. Vendimi përfundimtar pasqyrohet në procesverbal, i cili mbahet dhe njoftohet sipas pikave 1–3 të nenit 45 të ligjit për inspektimin. Shpjegimi dhe dëgjimi i subjektit nuk është i nevojshëm kur nuk konstatohen shkelje të kërkesave ligjore.

Neni 15

Shkelja e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit

1. Kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël apo për të cilën ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ, subjekti i inspektimit dënohet me “paralajmërim”. Paralajmërimi është dënim administrativ.

2. Subjekti i inspektimit mund të dënohet drejtpërdrejt me një dënim tjetër kryesor administrativ, më të rëndë, të parashikuar në ligjin e posaçëm, kur:

- a) nuk zbaton plotësisht dhe brenda afatit të përcaktuar detyrat e mëparshme;
- b) përsërit shkeljen e kërkesave ligjore;
- c) shkelja e konstatuar apo pasojat e saj janë të rënda.

3. Bashkë me dënimin kryesor mund të jepen edhe dënimet plotësuese, sipas përcaktimit të ligjit të posaçëm. Për të njëjtën shkelje mund të vendoset një dënim kryesor dhe një apo më shumë dënime plotësuese.

4. Kur është e nevojshme, dënimi administrativ shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi i dënimit përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve që pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit.

5. Subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve mund të kryhet një inspektim i ri.

Neni 16

Dorëzimi i praktikës së inspektimit

1. Përgjegjësi i grupit të inspektimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në urdhrin e inspektimit, pas protokollimit të shkresës bashkëshoqëruese, i dorëzon drejtorit të inspektimit të sektorit të gazit natyror dosjen e inventarizuar të inspektimit të kryer.

Dosja e inspektimit përmban:



- a) kopje të urdhrit të inspektimit;
- b) procesverbalin e inspektimit i cili është kryer online;

c) relacionin përkatës të përpiluar nga përgjegjësi i grupit të inspektimit;

- ç) provat e siguruara gjatë inspektimit.

2. Në procesverbalin e inspektimit përcaktohet edhe masa administrative, sipas përcaktimeve të ligjit 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

3. Drejtori i inspektimit të sektorit të gazit natyror njihet me praktikën e dorëzuar brenda dy ditëve pune pas marrjes së saj në dorëzim, paraqet sugjerimet e tij të kryeinspektori.

KREU III DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

Dispozita të fundit

1. Këto rregulla janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga strukturat e MIE-s përgjegjëse për sektorin e gazit, si dhe ISHTI-ja.

2. Mosrespektimi i këtyre rregullave ngarkon me përgjegjësi dhe përbën shkak për procedim disiplinor në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve, si dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

URDHËR

Nr. 280, datë 1.10.2020

PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE TË PRAKTIKAVE NË MARRËDHËNIET NDËRMJET STRUKTURËS PËRGJEGJËSE, QË MBULON AKTIVITETIN E SEKTORIT TË GAZIT NATYROR NË MINISTRI, DHE INSPEKTORATIT SHETETËROR PËRGJEGJËS PËR SEKTORIN E GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; pikës 2, të kreut II, të vendimit nr. 573, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave dhe të procedurave në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse në sektorin e gazit natyror të ministrisë përgjegjëse për energjinë”, si dhe të vendimit nr. 410, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”,

URDHËROJ:

1. Struktura përgjegjëse që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit natyror në ministri të bashkëpunojë dhe të koordinojë veprimet me Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), në rolin e inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror, për të garantuar realizimin e rolit mbikëqyrës të ministrisë në sektorin e gazit natyror, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, për sa u përket zbatimit të kërkesave dhe rregullave teknike, procedurave, kushteve e standardeve në fuqi në aktivitetet për projektimin, ndërtimin dhe përdorimin e infrastrukturës, të instalimeve e pajisjeve të sektorit të gazit, të cilat realizohen nga shoqëritë që kryejnë veprimtari në sektorin e gazit natyror sipas lejeve dhe licencave përkatëse, duke përfshirë edhe kontrollin për cilësinë e gazit natyror.

2. Struktura përgjegjëse që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit natyror në ministri të bashkëpunojë dhe të koordinojë veprimet me ISHTI, në funksion të realizimit të rolit dhe funksionit të saj



mbikëqyrës në sektorin e gazit natyror në Shqipëri, për sa ka të bëjë me:

a) përmbushjen e detyrimit për të garantuar projektimin, ndërtimin, përdorimin e sigurt dhe respektimin e rregullave teknike përkatëse të infrastrukturës në sektorin e gazit natyror dhe lidhjen e saj në kuadër rajonal;

b) garantimin e gjendjes teknike e teknologjike funksionale të infrastrukturës dhe instalimeve të gazit natyror për të siguruar një furnizim cilësor, të qëndrueshëm e të sigurt me gaz natyror, si dhe funksionimin e një tregu konkurrues dhe të liberalizuar;

c) mbështetjen dhe realizimin e masave të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit, duke aplikuar vlerësime e procedura të njëjta për të licencuarit dhe operatorët e tjerë në sektorin e gazit natyror, përfshirë edhe linjat direkte,

ç) trajtimin e çështjeve lidhur me vendosjen e penaliteteve për shkelje të mundshme të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me zbatimin dhe respektimin e rregullave të standardeve teknike në përdorimin e infrastrukturës dhe të instalimeve të gazit natyror.

3. Për probleme që i adresohen strukturës përgjegjëse në ministri, që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit natyror, të cilat trajtojnë dhe/ose lidhen me materiale dhe informacione e të dhëna të karakterit teknik apo që përfshijnë edhe çështje të karakterit teknik, struktura/njësia përgjegjëse në ministri kërkon bashkëpunimin/mendimin e ISHTI-së.

4. Struktura/drejtoria përkatëse e ISHTI-së, që mbulon aktivitetin për sektorin e gazit natyror dhe njësia/struktura përgjegjëse pranë ministrisë të ofrojnë dhe të shkëmbejnë informacion, në lidhje me gjendjen dhe problemet e zhvillimet të sektorit të gazit natyror në vend.

5. ISHTI-ja të krijojë një bazë të dhënash dhe të bëjë përditësimin e saj për të gjithë operatorët që do të ofrojnë shërbim, si: furnizim, transportim, depozitim, shpërndarje, konsumator fundor dhe çdo lloj operimi, në lidhje me gazin natyror, duke informuar edhe strukturën përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

6. Çdo katërmujor struktura/njësia përgjegjëse për sektorin e gazit natyror në ministri në bashkëpunim me ISHTI-në, në rolin e inspektoratit shtetëror përgjegjës për gazin natyror, mbi bazën e informacioneve dhe të dhënave të grumbulluara

gjatë inspektimeve për gjendjen teknike të objekteve, instalimeve dhe pajisjeve në shoqëritë që kryejnë aktivitet në sektorin e gazit natyror, si dhe mbi bazën e informacioneve me të dhëna nga shoqëritë operatore në sektorin e gazit, të përgatisin një raport informues për ministrinë për rezultatet e inspektimeve të kryera, si dhe për gjendjen teknike të objekteve, instalimeve dhe pajisjeve, si dhe për cilësinë e gazit, në shoqëritë që kryejnë aktivitet në sektorin e gazit natyror.

Brenda muajit mars të çdo viti struktura/njësia përgjegjëse për sektorin e gazit natyror në ministri, në bashkëpunim me ISHTI-në, përgatisin dhe dorëzojnë në ministri raportin vjetor për vitin paraardhës.

7. Struktura/njësia përgjegjëse për sektorin e gazit natyror në ministri bashkëpunon me ISHTI-në për përpunimin e praktikës që paraqitet për miratim të titullari i ministrisë për modelin e kartës së identifikimit të inspektorit, në respektim të kërkesave të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë, dhe të kërkesave të pikave 5 dhe 6, të kreut II, të VKM-së nr. 573, datë 3.10.2018, “Për miratimin e rregullave dhe të procedurave në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse në sektorin e gazit natyror të ministrisë përgjegjëse për energjinë”, si dhe të përcaktimeve të urdhrit të ministrit nr. 170, datë 8.6.2020, “Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së kartës së identifikimit për inspektorin që kryen inspektim teknik në sektorin e gazit natyror”.

Inspektorët, që i ushtrojnë aktivitetet në fushën e përgjegjësisë së ISHTI-së dhe janë të pajisur me kartën e identifikimit të ISHTI-së nga inspektori i përgjithshëm, kanë të drejtën të ushtrojnë atributet e inspektorit.

8. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), në rolin e inspektoratit shtetëror përgjegjës për gazin natyror, të angazhojë në njësinë/drejtorinë përgjegjëse për sektorin e gazit natyror punonjës të kualifikuar, të cilët kanë:

- ekspertizën e duhur teknike në fushën e gazit natyror, si dhe brenda një periudhe trevjeçare të jenë të pajisur me certifikatën profesionale për kategorinë përkatëse në zbatim të kërkesave të VKM-së nr. 551, datë 18.6.2015, “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin,



prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure”, të ndryshuar.

- ekspertizën e duhur juridike në fushën e sektorit hidrokarbur, si dhe brenda një periudhe trevjeçare janë pajisur me dokumentin/certifikimin përkatës të ekspertit jurist, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10433, datë [16.6.2011](#), “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

9. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) bashkëpunon me strukturën/njësine përgjegjëse për sektorin e gazit në ministri për ngritjen e kapaciteteve në njësine/drejtorinë përgjegjëse të ISHTI-së, që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit natyror.

10. Struktura/njësia përgjegjëse për sektorin e gazit natyror në ministri bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), në rolin e inspektoratit shtetëror përgjegjës për gazin natyror, në procesin e përgatitjes së rregullave teknike për sektorin e gazit natyror në zbatim të përcaktimeve të nenit 10, “Rregullat teknike dhe të sigurisë në sektorin e gazit natyror”, të ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

11. Në rastet kur gjatë mbikëqyrjes/inspektimit në shoqëritë që kryejnë veprimtari të gazit natyror, sipas lejeve dhe licencave përkatëse janë konstatuar parregullsi dhe mangësi në aspektin e zbatimit të kërkesave dhe rregullave teknike, të cilat nuk janë eliminuar pas inspektimeve të mëparshme ose është e nevojshme për të eliminuar një rrezik të menjëhershëm për jetën, shëndetin dhe pronën e qytetarëve, si dhe për shkak të kompleksitetit të mbikëqyrjes apo për rëndësinë e eliminimit të defekteve teknike e teknologjike, struktura/njësia përgjegjëse për sektorin e gazit natyror në ministri në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), në rolin e inspektoratit shtetëror përgjegjës për gazin natyror, i propozojnë ministrit për të urdhëruar kryerjen e inspektimeve të kombinuara me ministritë e tjera, në zbatim të përcaktimeve të pikës 3, të kreut IV, të VKM-së nr. 573, datë 3.10.2018, “Për miratimin e rregullave dhe të procedurave në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse në sektorin e gazit natyror të ministrisë përgjegjëse për energjinë”.

12. Për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në

Fushën e Hidrokarbureve, si dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 281, datë 1.10.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR PËRMBAJTJEN E URDHËRIT TË
INSPEKTIMIT, TË LËSHUAR NGA
INSPEKTORATI SHTETËROR TEKNIK
DHE INDUSTRIAL (ISHTI), NË ROLIN
E INSPEKTORATIT SHTETËROR
PËRGJEGJËS PËR SEKTORIN E GAZIT
NATYROR, PËR KRYERJEN E
INSPEKTIMEVE NË OBJEKTET E
TRANSMETIMIT, SHPËRNDARJES
DHE DEPOZITIMIT TË GAZIT
NATYROR, TË TERMINALEVE TË
GAZIT NATYROR TË LËNGËZUAR, SI
DHE TË OBJEKTEVE TË TJERA
TË GAZIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të pikës 1, të kreut VI, të vendimit nr. 573, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave dhe të procedurave në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse në sektorin e gazit natyror të ministrisë përgjegjëse për energjinë”, si dhe të vendimit nr. 410, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”

URDHËROJ:

1. Kryerja e inspektimeve teknike në objektet e transmetimit, shpërndarjes dhe depozitimit të gazit natyror, të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar, si dhe të objekteve të tjera të gazit, realizohet nga inspektorët e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) në rolin e inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror, mbi bazën e urdhrit të inspektimit të lëshuar nga kryeinspektori.

2. Inspektorët e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), që mbulojnë aktivitetet për



sektorin e gazit natyror për realizimin e inspektimeve teknike në objektet e transmetimit, shpërndarjes dhe depozitimit të gazit natyror, të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar, duhet të jenë të pajisur me kartën e identifikimit të inspektorit për gazin natyror, sipas përcaktimeve të urdhrit të ministrit nr. 170, datë 8.6.2020, “Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së kartës së identifikimit për inspektorin që kryen inspektim teknik në sektorin e gazit natyror”.

3. Objekti i inspektimeve teknike do të jetë zbatimi i dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, për sa ka të bëjë me aspektet teknike të projektimit, ndërtimit dhe shfrytëzimit të instalimeve dhe pajisjeve që shërbejnë për transmetimin, shpërndarjen, depozitimin nëntokësor të gazit natyror, si dhe terminalët e gazit natyror të lëngëzuar, për sa ka të bëjë me rregullat teknike përkatëse, në lidhje me performancën e veprimtarive të gazit nga ana e subjekteve që kryejnë veprimtari gazi, subjekteve të sektorit publik dhe shfrytëzuesve të sistemit të gazit.

4. Në procesin e inspektimit teknik, nga ana e inspektorëve duhet të përfshihet inspektimi për çështjet si më poshtë, por pa u kufizuar, lidhur me:

a) disponimin e lejes së ndërtimit dhe operimit të infrastrukturës së gazit natyror miratuar nga Këshilli i Ministrave;

b) disponimin e dokumentacionit të plotë teknik për vendosjen e pajisjeve dhe të instalimeve;

c) verifikimin nëse instalimi dhe testimi i pajisjeve të gazit është kryer në përputhje me ligjin dhe rregullat teknike përkatëse;

ç) respektimin e kushteve që përfshihen në marrëveshjen e lidhur në përdorimin e instalimeve në sektorin e gazit;

d) verifikimin nëse ka modifikime të miratimit të dhënë që ndryshojnë objektin e këtij miratimi;

dh) verifikimin nëse është kryer kontrolli dhe testimi në përputhje me rregullat teknike dhe standardet e instalimeve;

e) kontrollin nëse punëmarrësit që përdorin dhe mirëmbajnë instalimet e gazit janë pajisur me dëshmitë përkatëse;

ë) verifikimin nëse është i plotë dokumentacioni në dosjen teknike të shërbimit të ngarkuar për kontrollin;

f) verifikimin nëse respektohen distancat e sigurisë, në rastin e:

- i. zgjedhjes së gjurmës;
- ii. vendosjes së tubacionit në tokë;
- iii. vendosjes së tubacionit në sipërfaqe;
- iv. vendosjes në hapësirat publike që preken nga trafiku rrugor dhe hekurudhor;
- v. kalimit në plane dhe rrjedhjeve të ujërave;
- vi. kalimit në pyje;

g) verifikimin nëse është kryer kontrolli i tubove dhe i pajisjeve ndihmëse konform normave dhe specifikimeve të lejuara (dokumentacioni):

i. realizimi i kontrollit gjatë montimit (procesverbalet e provave) dhe mbrojtja e tubacionit;

ii. realizimi i kontrollit në instalimet anekse, kontroll mbi distancat e vendosjes, rrethimi, ndërtesat dhe lokalet, mbrojtja nga rreziqet elektrike, parandalimi i ndotjes së ujërave, mjetet e mbrojtjes nga zjarri, vendet e kontrollit etj.;

gj) verifikimin nëse zbatohen rregullat e shfrytëzimit, udhëzimet dhe instruksionet, mirëmbajtja, punimet, mbikëqyrja, ndërhyrjet etj.

5. Përmbajtja e formularit të urdhrit të inspektimit duhet të jetë sipas shtojcës 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje, dhe në të duhet të përfshihen:

i. të dhëna të përgjithshme të subjektit në të cilin do të bëhet inspektimi teknik;

ii. listëverifikimi për operatorët që kryejnë veprimtari në sektorin e gazit natyror;

iii. objekti i inspektimit.

6. Në rast se gjatë kryerjes së inspektimeve teknike evidentohen çështje dhe probleme specifike që nuk janë përfshirë në këtë model të urdhrit të inspektimit, kryeinspektori i propozon ministrit miratimin e ndryshimeve përkatëse.

7. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masat e nevojshme organizative, si dhe të përcaktojë fondet e nevojshme për përgatitjen e kopjeve të sekretuara të urdhrave të inspektimit.

8. Ngarkohet Drejtoria e Programit të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve, si dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku



SHTOJCA I

FORMULAR-URDHËR INSPEKTIMI

Miratoi
Kryeinspektori
()

Nr. 000001

Datë:...../...../2020

Qarku:

Subjekti i inspektuar për herë të

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SUBJEKTTIT

1	Emri i subjektit	
2	Data e fillimit të aktivitetit	
3	Lloji i aktivitetit/licenca e operimit	
4	Adresa – Qendër (Rrugë, njësi, telefon)	
5	Adresa të tjera – Filiale (Rrugë, njësi, telefon)	
6	Përfaqësuesi i subjektit/drejtuesi teknik (Emër, atësi, mbiemri)	
7	NUIS – QKB (Nr. Unik i Identifikimit)	
8	Tipi i pronësisë	Tipi i subjektit

2. LISTË VERIFIKIMI PËR OPERATORËT QË KRYEJNË VEPRIMTARI NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

Niveli teknologjik			
Operator i sistemit të transmetimit			
Operator i sistemit të shpërndarjes			
Operator i magazinimit			
Operator i terminalit			
Subjekte të tjera			

Tipi i inspektimit			
Inspektim fillestar			
Inspektim i programuar			
Riinspektim			
Inspektim jashtë programit (rastësor, emergjencë)			
Inspektim i kombinuar			

3. OBJEKTI I INSPEKTIMIT

			Komente
A ka leje ndërtimi dhe operimi të infrastrukturës së gazit natyror miratuar nga Këshilli i Ministrave			
Miratimi i organit përkatës për punimet ndërtimore është përfituar në përputhje me legjislacionin për objektet e ndërtimit			
A ka dokumentacion të plotë teknik për vendosjen e pajisjeve dhe të instalimeve.			
A është kryer instalimi dhe testimi i pajisjeve të gazit në përputhje me ligjin dhe rregullat teknike përkatëse			
Gjatë funksionimit të tyre, subjektet e sektorit të gazit,			



plotësojnë në kryerjen e veprimtarisë kushtet e përcaktuara nga ligji për operim të sigurt të sistemit			
A respektohen kushtet që përfshihen në marrëveshjen e lidhur në përdorimin e instalimeve në sektorin e gazit.			
A ka modifikime të miratimit të dhënë që ndryshojnë objektin e këtij miratimi			
A është kryer kontrolli dhe testimi në përputhje me rregullat teknike dhe standardet e instalimeve			
A janë pajisur punëmarrësit që përdorin dhe mirëmbajnë instalimet e gazit me dëshmitë përkatëse			
A është i plotë dokumentacioni në dosjen teknike të shërbimit të ngarkuar për kontrollin			
A respektohen distancat e sigurisë në rastin e: - zgjedhjes së gjurmës; - vendosjes së tubacionit në tokë; - vendosjes së tubacionit në sipërfaqe; - vendosjes në hapësirat publike që preken nga trafiku rrugor dhe hekurudhor; - kalimit në plane dhe rrjedhjeve të ujërave; - kalimit në pyje.			
A është kryer kontrolli i tubove dhe pajisjeve ndihmëse konform normave dhe specifikimeve të lejuara (dokumentacioni)			
Realizimi i kontrollit gjatë montimit (procesverbalet e provave) dhe mbrojtja e tubacionit			
Instalimet anekse. Kontroll mbi distancat e vendosjes, rrethimi, ndërtesat dhe lokalet, mbrojtja nga rreziqet elektrike, parandalimi i ndotjes së ujërave, mjetet e mbrojtjes nga zjarri, vendet e kontrollit etj.			
Rregullat e shfrytëzimit, udhëzimet dhe instruksionet, mirëmbajtja, punimet, mbikëqyrja, ndërhyrjet etj.			
A është në përputhje me standardet në fuqi cilësia e gazit të furnizuar			

Inspektorët e ISHTI-t

Përfaqësuesi i subjektit



URDHËR
Nr. 284, datë 7.10.2020

PËR MIRATIMIN E LEJES SË RE TË
QARKULLIMIT TË MJETEVE
RRUGORE

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 92 dhe 93, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 7, të udhëzimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4, datë 28.6.2019, “Për dokumentet për qarkullim dhe regjistrim të mjeteve rrugore”, të ndryshuar; direktivës Evropiane 1999/37/EC, datë 29.4.1999, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Për dokumentet e regjistrimit të mjeteve”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Leja e re e qarkullimit të jetë sipas modelit bashkëlidhur këtij urdhri, i cili është në përputhje të plotë me direktivën Evropiane 1999/37/EC,

datë 29.4.1999, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Për dokumentet e regjistrimit të mjeteve”, të ndryshuar, dhe sipas propozimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, me shkresën nr. 17699 prot., datë 21.9.2020, “Projekt propozim mbi modelin, specifikimet dhe mënyrat e plotësimit të dokumentit të qarkullimit, të ri, të mjeteve rrugore”.

2. Leja e re e qarkullimit të jetë e barasvlershme me certifikatën e pronësisë.

3. Prodhimi dhe plotësimi i lejes së re të qarkullimit të bëhet sipas rregullores së hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

Përmbajtja:		REPUBLICA E SHQIPËRISË REPUBLIC OF ALBANIA	
(A) Numri i regjistrimit (targa)	(N.4) Aks 4 (në kg), kur është e përshtatshme	 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR GENERAL DIRECTORATE OF ROAD TRANSPORT SERVICES LEJE QARKULLIMI Registration Certificate Carta di circolazione / Registration Certificate / Zulassungsbesecheinigung / Certificat d'immatriculation / Aksa kukkopojaz / Permiso de circulacion / Certificado de matricula / Prometna dozvola / Prometno dovoljenje / Cauterenstvo o peticipacim / Osvedčení o registraci / Osvedčení o evidenci / Dowód Rejestracyjny / Forgalmi engedély / Certificat de înmatriculare / Teaslas Clárach / Registreringsattest / Registreringsbeviset / Reisterintidustus / Reistreemistunnistus / Registracijos liudijimas / Kentekenbewijs / Transportdzelva registrācijas apliecība / Certificat de Registração	
(B) Data e regjistrimit të parë të mjetit	(N.5) Aks 5 (në kg), kur është e përshtatshme		
(B.1) Viti i prodhimit	(O) Masa maksimale teknike të lejuar e rimorkios që mund të tërhiqet:		
(C) Të dhëna personale	(O.1) Në frenim (në kg)		
(C.1) Mbatësi i lejes së qarkullimit	(O.2) Në lëvizje (në kg)		
(C.2) Pronari i mjetit	(P) Motori:		
(C.2.1) Mbiemri ose emri i subjektit	(P.1) Kapaciteti (cilindrata) e motorit (në cm³)		
(C.2.2) Emri(lat) ose inicial(lat)	(P.2) Fuqia maksimale neto (në kW) (nëse është e disponueshme)		
(C.2.3) Adresa në datën e lëshimit të dokumentit	(P.3) Lloji i karburantit ose burimi i energjisë		
(C.3) Person fizik ose juridik që mund të përdorë mjetin në bazë të një të drejte juridike, përveç asaj të pronësisë	(P.5) Numri i identifikimit të motorit		
(D) Mjeti:	(Q) Raporti i fuqisë me peshën, vetëm për mjete motor (në kW/kg)		
(D.1) Marka (emri i prodhuesit)	(R) Ngjyra e mjetit		
(D.2) Tipi	(S) Kapaciteti i vendeve		
(D.3) Emërtimi tregtar	(S.1) Numri i ndenjësive, përfshirë atë të drejtuesit mjetit		
(E) Numri i identifikimit të mjetit (numri i shasisë)	(S.2) Numri i vendeve të qëndrimit në këmbë (aty ku është e përshtatshme)		
(F) Masa	(T) Shpejtësia maksimale (km/orë)		
(F.1) Masa maksimale me ngarkesë të plotë teknike dhe lejueshme. Përfshihen motorët me ose pa kosh	(U) Niveli i zhurmës:		
(F.2) Masa maksimale, me ngarkesë të plotë, e lejuar për qarkullim në Shqipëri	(U.1) Në ndalim [në dB (A)]		
(F.3) Masa maksimale, me ngarkesë të plotë, e kompleksit (mjet+rimorkio) e lejuar për qarkullim në Shqipëri	(U.2) Për regjim normal të motorit (në min-1)		
(G) Masa e mjetit, përjashtuar ato të kategorisë M1, përfshi karrocërinë dhe pajisjet bashkuëse (masa bosh)	(V) Emetimi i gazrave që shkarkohen:		
(H) Data e regjistrimit të cilit referohet kjo leje qarkullimi	(V.1) CO (në g/km ose g/kWh)		
(J) Kategoria e mjetit sipas klasifikimit ndërkombëtar	(V.2) HC (në g/km ose g/kWh)		
(J.1) Destinacioni dhe përdorimi i mjetit	(V.3) NOx (në g/km ose g/kWh)		
(J.2) Kodi i karrocërisë	(V.5) Grimcat për naftë (në g/km ose g/kWh)		
(K) Numri i miratimit të tipit (nëse është e disponueshëm)	(V.6) Koefficienti i korrigjimit të absorbimit për naftë (në min-1)		
(K.1) Numri i miratimit individual (kombëtar)	(V.7) CO ₂ (në g/km)		
(L) Numri i akteve	(V.9) Tregues i kategorisë mjedisore të miratimit të tipit KE; referencë ndaj versionit të zbatueshëm në përputhje me Direktivën 70/220/EEC ose Direktivën 88/77 / EEC		
(M) Distanca midis akteve (në mm)	(X) Data e skadimit të certifikatës së kontrollit teknik		
(N) Për mjete me një total mbi 3500 kg, shpërndarja teknike e lejuar e masës maksimale, me ngarkesë të plotë, sipas akteve:	1. Numri i cilindrave të motorit	vula e sigurisë	
(N.1) Aks 1 (në kg)	2. Numri i dyerve		
(N.2) Aks 2 (në kg), kur është e përshtatshme	3. Lloji i kutisë së shpejtësisë		
(N.3) Aks 3 (në kg), kur është e përshtatshme	4. Lloji i mjetit	Numri Serial:	
	5. Përmasat e gomave		

Kjo leje qarkullimi është e barasvlershme dhe me certifikatën e pronësisë!



2		3			4		
No.	[A]	[D.1] [D.2] [D.3] [E] [F.1] [F.2] [F.3] [G] [J] [J.1] [J.2] [K] [K.1] [L] 5 [M] [N.1] [N.2] [N.3] [N.4] [N.5] [O.1] [O.2] [P.1] [P.2] [P.3] [P.5] [Q] [R] [S] [S.1] [S.2]			[T] [U.1] [U.2] [V.1] [V.2] [V.3] [V.5] [V.6] [V.7] [V.9]		
[B]	[B.1]						
[C]							
[C.2]							
[I]	[X]				Shënime: 1. 2. 3. 4. 5.		

Nënshkrimi, Vula

URDHËR

Nr. 577, datë 14.10.2020

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË
NË URDHRIN NR. 266/1, DATË 1.9.2020,
PËR MARRJEN E MASAVE TË
VEÇANTA NGA KOMISIONET E
VLERËSIMIT TË AFTËSISË SË
KUFIZUAR DHE INVALIDËVE TË
PUNËS PËR PARANDALIMIN E
PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË
SHKAKTUAR NGA COVID-19**

Në mbështetje të nenit 116, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri”, si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Pika 2 e urdhrit nr. 266/1, datë 01.09.2020, i ndryshuar, riformulohet si më poshtë:

“2. Tejkalimi i afateve të vlerësimit/rivlerësimit të aftësisë së kufizuar, gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, të përcaktuar në vendimin nr. 182, datë 26.2.2020, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal”, të ndryshuar, nuk përbën shkak për ndërprerjen e pagesave të aftësisë së kufizuar”, për përfituesit të cilëve iu ka përfunduar afati i përfitimit sipas vendimit të komisionit. Trajtimi me pagesë bëhet deri në momentin e rikomisionimit të tyre”.

2. Pas pikës 7, të urdhrit nr. 266/1, datë 1.9.2020, të ndryshuar, shtohen pikat 7.1 dhe 7.2 me këtë përmbajtje:

“7.1 Përgjashtimisht, gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 paraqitja e personave në komisionin e nivelit të parë, sipas pikave 1.1 dhe 1.2, të kreut II, të vendimit nr. 182, datë 26.2.2020, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal”, të ndryshuar, pikave 2.1 dhe 2.2, të udhëzimit nr. 2365, datë 26.11.2008, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, “Për përfitimet



nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar, realizohet me komisionin, personalisht përmes platformave *online* dhe në prani të përfaqësuesit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (mjek), në vendbanimin e personit.

7.2 Paraqitja në KMCAP-në eprore bëhet me prezencën fizike të personit. Vetëm në raste të veçanta, kur gjendja shëndetësore e rënduar është e argumentuar nga mjeku specialist përkatës, së bashku me arsyen e pamundësisë së paraqitjes në komision, si edhe kur KMCAP-ja eprore gjykon që paraqitja fizike është e pamundur, procedura e vlerësimit bëhet përmes platformave *online*, në prezencë të përfaqësuesit të Drejtorisë Rajonale të

Shërbimit Social Shtetëror (mjek) ose me prezencën e anëtarit/ve të komisionit epror, në vendbanimin e personit.”.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror. dhe anëtarët e KMCAP-ve/ KMPV-ve të nivelit të parë dhe KMCAP-së eprore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Bardhylka Kospiri

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë